

RELACION KONSTRUKTIV

OBJEKTI:PALESTER PUKE

POROSITES :.....

ADRESA:

- TE DHENA TE PERGJITHSHME

Kompleksi "Palester Puke" I perket kategorise se veprave civile me qellim sherbimesh dhe argetimi te nje rendesie te zakonshme.

Projekti parashikon ndertimin e ketij OBJEKTI ,te perbere nga nje godine, fushe basketbolli e mbuluar, me hapesire drite 24,5 m dhe me lartesi 8 m,si edhe te hollit te hyrjes me ambientet e sherbimit dhe me lartesi 5,4m dhe hapesire drite 6,8 m

Mbeshtetur ne keto permasa gabarite, ky object nga konceptimi konstruktiv eshte ndare ne dy godina te vecanta te vecuara nga njera tjetra me fuge.

GODINA E FUSHES SE BASKETBOLLIT :

Nenstruktura e objektit eshte e konceptuar me theme te vecanta dhe me trare themeli me dimensione 30x50.

Struktura metalike mbi kuoten 0,00 eshte llogaritur me rama hapsinore duke siguruar bashkepunim midis elementeve nen efektin e ngarkesave te jashtme dhe duke garantuar zhvendosje te lejuara ne te dydrejtmet.

Perzgjedhja e konstruksionit me structure metalike ka qene e imponuar nga hapesira e madhe e drites 24,5 m.

Rrjeti I kolonave metalike dhe I kapriatave eshte orientuar ne menyre te tille qe te siguroje qendrueshmerine e objektit si dhe zhvendosjet e tij Brenda kushtevet e lejuara nga **KTP**.

Per aresye ekonomike eshte preferuar mbulimi I kesaj godine me kapriate metalike.

HOLLI I GODINES

Holli I godines,nisur nga permasat dhe motivet ekonomike gjithashtu, eshte bere me strukture tradicionale, themele me mur guri, mur tulle mbajtes, solete me polisterol dhe suvatimet, sipas pershkrimit te arkitektit te objektit.

Ne projekt eshte parashikuar qe dy godinat te jene komplet te pavaruara statikisht nga njera tjetra duke filluar qe nga themeli. Dmth asnjera ngarkese reagimi e njeres godine, nuk ndikon tek tjetra

- REFERENCAT

Per llogaritje jane marre parasysh

- 1- K.T.P. (Kushtet Teknike te Projektimit)
- 2- EC-2 ; EC-8

- MATERIALET E PERDORURA

Materialet e perdorura jane konforme EN 1992-1-1:2004 .

Betoni, si per elementet vertikale edhe per ata horizontal, I perket klases **C25/30** .

Celiku I perket klases S500 .

- LLOGARITJET KOMPJUTERIKE

Modelimi I structures eshte realizuar ne programin llogarites SAP2000 I cili mbeshtetet ne llogaritjen sipas elementeve te fundem .

Per llogaritjen e themelit ,nuk ka studim gjeologjik, sforcimet e lejuara jane pranuar $= 1,8 \text{ kg/cm}^2$.

Ne baze te kerkesave te Eurocodit, per toke me $= 1,8 \text{ kg/cm}^2$, eshte percaktuar kategoria e tokes, rendesia e objektit, si dhe parametrat sizmike te tokes.

Soleta ne holl eshte monolite e modeluar me elemente "shell" katerkendore (me 6 shkalle lirije per nyje) me programin HOLOBIM, me trashesi 20 cm, me mbushje me polisterol. Diskretizimi I soletave eshte bere duke pasur parasysh qe rezultatet te jene sa me reale.

Traret jane konceptuar te thelluar me dimensione 30x50 cm ,

Per llogaritjen e godinave jane marre parasysh kombinimet e ngarkesave nga veprimi I ngarkesave te perhershme, te perkohshme dhe atyre sizmike dhe nga to eshte zgjedhur kombinimi me I disfavorshem per godinat ne fjale.

Ngarkesat e perhershme jane llogarite nga vete programi ne baze te dimensioneve dhe peshes se elementeve konstruktiv.

PER "SPEED" SH.P.K.
KONSTRUKTOR
ING./**PETRAQ KOKA** /
LIÇ. K 0272/4